
Policia e Finlandës

Detyra e policisë në Finlandë është sigurimi i drejtësisë dhe rendit në shoqëri, mirëmbajtja e rendit publik dhe e sigurisë, si dhe parandalimi i krimeve, zbardhja e tyre dhe ngritja e akuzës. Gjithashtu policia kujdeset edhe për shumë detyra që kanë të bëjnë me çështjet e lejeve administrative lidhur me sigurinë.



Shërbimi i policisë

Në Finlandë ka 24 stacione policie, brenda të cilëve ka rreth 180 seksione të ndryshme shërbimi. Jo të gjithë stacionet e policisë kanë shërbim 24 orë në ditë.

Policia lokale përgjigjet për rendin dhe sigurinë e zonës përkatëse, për vëzhgimin e trafikut rrugor, për hetimet lidhur me çështje të ndryshme penale si dhe për çështjet e lejeve të ndryshme. Shërbimet e policisë për leje ofrohen edhe në zyrat e shërbimeve të përbashkëta.





112 Numri i përgjithshëm i urgjencës

Kur të keni nevojë për ndihmë urgjente, telefononi në numrin e përgjithshëm të urgjencës 112.

Kur të telefononi në numrin e urgjencës, nuk ka nevojë për prefiks, edhe kur të telefononi nga celulari. Mund të telefononi falas në numrin e përgjithshëm të urgjencës nga çdo telefon.



Hetimet

Zakonisht, për hetimin e një shkeljeje ligjore përgjigjet stacioni i policisë së vendit të ngjarjes. Njoftimin për shkelje ligjore mund ta bëni ku të dëshironi dhe pastaj është stacioni i policisë ai që e përcjell njoftimin tuaj në vendin e duhur.

Policia fillon hetimet paraprake nëse ka arsye të mjaftueshme për të dyshuar për shkelje ligjore. Jo të gjitha njoftimet në polici, mund të rezultojnë në hetime paraprake.



Rendi i përgjithshëm dhe siguria

Policia përgjigjet për ruajtjen dhe sigurinë e rendit të vendeve publike duke bërë patrullime, duke iu përgjigjur thirrjeve urgjente, duke organizuar mirëmbajtjen e sigurisë në evenimente të mëdha publike, duke këshilluar dhe informuar si dhe duke ndërhyrë në raste të shkeljeve ligjore.



Vëzhgimi i trafikut rrugor

Vëzhgimi i trafikut rrugor nga ana e policisë përqendrohet te kontrolli i shpejtësisë, te kontrolli i përdorimit të substancave intoksikuese dhe i mjeteve të sigurisë, si dhe te shoferët e rrezikshëm. Detyra e policisë është të ndërhyjë edhe në thyerjen e rregullave të tjera të trafikut rrugor.

Policia lokale kontrollon trafikun, kryesisht në qytete dhe njësitë e policisë së lëvizshme kontrollojnë kryesisht trafikun e rrugëve kryesore.



Shërbimet e lejeve

Policia lokale përgjigjet për shërbimet e lejeve për banorët e zonës që mbulon. Shërbimet e lejeve të policisë mund të kryhen edhe në zyrat e shërbimeve të përbashkëta. Pasaportat, letërnjoftimet, patentat e automjeteve, lejet për të huaj dhe lejet për armët e zjarrit janë pjesa më e madhe e lejeve që miraton policia. Për këto leje duhet që klienti të shkojë të paktën një herë në polici ose në zyrën e shërbimeve të përbashkëta, që të bëhet identifikimi i aplikantit. Lejet jepen kundrejt një pagese.

Kërkesat që bëhen jashtë Finlandës për lejeqëndrim, leje pune si dhe për viza dorëzohen në përfaqësinë e Finlandës.



Sendet e gjetura

Për sendet e gjetura duhet të lajmëroni pronarin e tyre ose t'i dorëzoni ato në polici. Të gjitha sendet, blerja dhe mbajtja e të cilave është e ndaluar me ligj ose kërkon leje zyrtare, si për shembull, drogat, alkooli i paligjshëm dhe armët, duhet t'i dorëzohen menjëherë policisë.

Pronari i sendit të humbur ka të drejtë që të rimarrë sendin e humbur nëse ai i pagon një shpërblim personit që ka gjetur sendin dhe kompenson dëmet e shkaktuara nga gjetja e sendit.





Informacione të mëtejshme

www.poliisi.fi

www.polis.fi

www.police.fi

